ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **242-26-9681-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me licencë softuerike për verifikimin e integritetit editorial të revistave shkencore (Pjesa 1)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

UNISOFT L.L.C.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Shpend Llagami, Nr. 21

(Adresa)

Prishtinë, Kosovë — **10000**

(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 44 250 052

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Arianit Bytyqi, përfaqësues i autorizuar

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@unisoft-rks.com

(Adresa elektronike)

26.11.2026 — **Arianit Bytyqi – UNISOFT L.L.C.**

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë (B05) është publikuar në platformën e-Prokurimi (https://e-prokurimi.rks-gov.net) më 03.11.2026, së bashku me dosjen e tenderit dhe Aneksin 1 – "Specifikimet teknike të detyrueshme". Aktiviteti nuk ka arritur fazën e hapjes së tenderëve; nuk është publikuar njoftim për dhënie të kontratës apo për anulim. Ankesa i përket fazës para dorëzimit të tenderëve dhe ka të bëjë me Pjesën 1 – licenca e platformës për verifikimin e integritetit editorial të revistave shkencore.

Lloji i dokumentit	**Data**
B05 – Njoftim për kontratë (me dosjen e tenderit dhe Aneksin 1)	03.11.2026
Kërkesë për informacione shtesë / sqarime nga UNISOFT L.L.C. (Aneksi 5)	13.11.2026
Përgjigje e AK në kërkesën për informacione shtesë / sqarime	16.11.2026
Kërkesë për rishqyrtim nga UNISOFT L.L.C.	20.11.2026
Vendim i AK për kërkesën për rishqyrtim – refuzohet si e pabazuar	23.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk aplikohet. Ankesa ka të bëjë me fazën para dorëzimit të tenderëve – me Njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike të Pjesës 1.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **X** **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Detajet:

- Më 20.11.2026 UNISOFT L.L.C. ka parashtruar te AK – Universiteti i Prishtinës Kërkesë për rishqyrtim, sipas nenit 108A të LPP-së, kundër Njoftimit për kontratë dhe specifikimeve teknike të Pjesës 1, duke pretenduar shkelje të neneve 1, 7 dhe 28 të LPP-së.
- Më 23.11.2026 AK ka nxjerrë Vendimin me të cilin: I. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim; II. Vërtetohet Njoftimi për Kontratë.
- Ankesa parashtrohet brenda afatit prej 10 ditësh nga pranimi i vendimit të AK-së, siç përcaktohet edhe në këshillën juridike të vendimit. Kopja e vendimit të AK-së bashkëngjitet kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (në tekstin e mëtejmë: LPP), dhe se Vendimi i AK-së i datës 23.11.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, nuk i ka eliminuar këto shkelje:

- **Neni 1** – Qëllimi
- **Neni 7** – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
- **Neni 28** – Specifikimet teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesa mbështetet në të njëjtat pretendime të paraqitura në Kërkesën për rishqyrtim të datës 20.11.2026 (e bashkëngjitur). Për secilin pretendim, më poshtë paraqitet edhe qëndrimi i AK-së në Vendimin e datës 23.11.2026 dhe kundërargumenti i ankuesit.

Vërejtje paraprake për Vendimin e AK-së

Vendimi në pjesën përmbyllëse thekson shprehimisht se "është përgatitur edhe nga hartuesi i specifikave teknike nga njësia kërkuese"; tabela përmbledhëse e titullon kolonën e vlerësimit "Qëndrimi i hartuesit", ndërsa në pikën 8 thuhet "Kjo pikë nuk është në kompetencë të hartuesit të specifikimeve". Pra, pretendimet për shkeljen e LPP-së në specifikimet teknike i ka vlerësuar faktikisht vetë hartuesi i tyre. Një rishqyrtim i tillë nuk siguron vlerësim objektiv dhe të paanshëm, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe trajtimit të drejtë (nenet 1 dhe 7 të LPP-së). Për këtë arsye, ankuesi i propozon OSHP-së që specifikimet e Pjesës 1 t'i vlerësojë përmes ekspertit shqyrtues të pavarur.

Po ashtu, AK pretendon se kërkesa për rishqyrtim "nuk sjell asnjë fakt të ri, por përsërit pyetjet e Aneksit 5". Kërkesa për rishqyrtim është mjet juridik kundër dosjes së tenderit siç është sqaruar më 16.11.2026; ajo i përsërit pretendimet pikërisht sepse përgjigjet e AK-së nuk i kanë eliminuar shkeljet, por i kanë konfirmuar ato.

Neni 1 – paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1 - Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

1. **Faktet.** Më 03.11.2026 Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Prishtinës ka publikuar Njoftimin për Kontratë (B05) për aktivitetin e prokurimit nr. 242-26-9681-1-2-1. Në Aneksin 1 – "Specifikimet teknike të detyrueshme", objekti i Pjesës 1 është përcaktuar si "licencë për qasje institucionale në platformën Cabells (Predatory Reports)", pa fjalët "ose ekuivalent". Edhe vetë emërtimi i aktivitetit, siç pasqyrohet në dokumentin e AK "Përgjigje në kërkesën për informacione shtesë / sqarime" të datës 16.11.2026, është "Furnizimi me Licencë softuerike të Platformës Cabells dhe Platformës AI Detection Capabilities – Enterprise dhe iThenticate for Corporate & Admissions 2.0 – Enterprise". Pra, lënda e prokurimit është ndërtuar që nga emërtimi rreth produkteve të prodhuesve të caktuar, e jo rreth nevojës funksionale të AK-së.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Titulli zyrtar i aktivitetit është neutral; emërtimi me "Cabells" është vetëm titull i punës në kokën e dokumentit të sqarimit (Pika*

1.1).

Kundërargumenti i ankuesit: Dokumenti i 16.11.2026 është akt zyrtar i AK-së, i nënshkruar nga Zyra e Prokurimit dhe nga hartuesi i specifikimeve, i publikuar në e-Prokurimi dhe – sipas vetë AK-së – "pjesë përbërëse e dosjes së tenderit". Në rubrikat "Aktiviteti i prokurimit" dhe "Pjesa (Loti) që sqarohet" ai e emërton aktivitetin dhe Pjesën 1 me emrat tregtarë të produkteve. AK nuk mund të pretendojë njëkohësisht se sqarimi është detyrues (për ta arsyetuar mosndryshimin e dosjes) dhe se emërtimet në të njëjtin sqarim janë pa rëndësi juridike. Për më tepër, objekti i Pjesës 1 në Aneksin 1 emërton platformën Cabells, pavarësisht titullit të përgjithshëm të aktivitetit.

2. Më 13.11.2026 OE UNISOFT L.L.C. ka parashtruar Kërkesë për informacione shtesë (Aneksi 5) me tetë pyetje të bazuara në nenet 7 dhe 28 të LPP-së, lidhur me: emërtimin e platformës Cabells pa "ose ekuivalent" (P1), pranimin dhe kriteret e ekuivalencës (P2), kërkesën për prodhues/partner të autorizuar (P3), pragun "mbi 20.000 revista" (P4), klasifikimin në tri shkallë (P5), kërkesën për përdorim institucional (P6), referencën në Shtojcën VII të Rregullores së UP-së (P7) dhe ndryshimin e dosjes (P8). AK është përgjigjur më 16.11.2026.

3. **Efikasiteti i shfrytëzimit të fondeve publike.** Efikasiteti dhe vlera për para, të cilat janë qëllimi themelor i nenit 1 të LPP-së, arrihen vetëm përmes konkurrencës reale. Specifikimet e Aneksit 1 – emërtimi i platformës Cabells, kërkesa që ofruesi të jetë prodhuesi ose partner i autorizuar prej tij, pragu "mbi 20.000 revista të vlerësuara", klasifikimi i shkeljeve sipas metodologjisë tre-shkallëshe dhe kërkesa për përdorim aktual në së paku 5 universitete nga 400 më të mirat sipas THE/QS ose në 5 universitete publike të BE-së – të marra në tërësi, e kufizojnë tregun faktikisht te një produkt i vetëm dhe te partnerët që ai produkt i autorizon. Në mungesë të konkurrencës, çmimi nuk formohet nga tregu, por diktohet nga prodhuesi, ndërsa kontrata lidhet për 36 muaj me çmim fiks. Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me detyrimin për shfrytëzimin "më efikas" të fondeve publike.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Vlera për para sigurohet përmes procedurës së hapur dhe konkurrencës ndërmjet çdo ofertuesi që ofron produktin e referuar ose një ekuivalent; UNISOFT nuk identifikon asnjë produkt të përjashtuar (Pikat 1.2, 1.5, 7.5).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Procedura e hapur siguron konkurrencë vetëm formalisht nëse specifikimet e mbyllin tregun. "Konkurrenca" ndërmjet ofertuesve që ofrojnë të njëjtin produkt, me çmim të diktuar nga i njëjti prodhues, nuk është konkurrencë reale dhe nuk e realizon shfrytëzimin "më efikas" të fondeve publike sipas nenit 1. Barra për të dëshmuar se tregu nuk kufizohet i takon AK-së (shih pikën 6 më poshtë).

4. **Transparenca.** Në përgjigjen e datës 16.11.2026 AK ka: (i) deklaruar se objekti i Pjesës 1 tani "lexohet" si "Licencë softuerike e Platformës Cabells (Predatory Reports) ose ekuivalent"; (ii) futur dhjetë kritere të reja minimale dhe të detyrueshme të ekuivalencës (K1–K10) me mjete indikative të dëshmimit; (iii) riformuluar kërkesën për klasifikimin e shkeljeve ("ose sistem ekuivalent i shkallëzuar"); dhe (iv) riinterpretuar kërkesën për autorizim nga prodhuesi. Njëkohësisht, AK deklaron (Pyetja 8) se "ndryshimi i dosjes së tenderit nuk është i nevojshëm". Si rezultat, Njoftimi për Kontratë dhe Aneksi 1 i publikuar mbeten me emrin e platformës Cabells dhe pa kriteret K1–K10, ndërsa kushtet reale të tenderit gjenden në një dokument sqarues. Ndryshimet me natyrë substanciale të specifikimeve teknike duhet të bëhen përmes ndryshimit formal të dosjes së tenderit dhe njoftimit përkatës, të publikuar në platformën e-Prokurimi, me zgjatjen e afatit sipas nenit 53 të LPP-së – jo përmes interpretimit në sqarim. Kjo praktikë krijon pasiguri juridike për ofertuesit lidhur me atë se cili tekst ka përparësi gjatë vlerësimit, si dhe largon nga konkurrenca operatorët ekonomikë të cilët, duke parë emrin e markës në Njoftimin për Kontratë, kanë vlerësuar se nuk kanë mundësi të konkurrojnë.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Sqarimi i 16.11.2026 është pjesë e dosjes, iu*

është komunikuar njëkohësisht të gjithë operatorëve sipas nenit 53 par. 6 të LPP-së dhe nuk i ka ndryshuar kriteret; prandaj ndryshimi formal i dosjes (B54) nuk ka qenë i nevojshëm (Pikat 1.3, 7.6, 28.4).

Kundërargumenti i ankuesit: Së pari, sqarimi ka ndryshuar përmbajtjen e specifikimit: objekti tani "lexohet" ndryshe (me "ose ekuivalent"), kërkesa për klasifikim është riformuluar ("ose sistem ekuivalent i shkallëzuar"), autorizimi nga prodhuesi është riinterpretuar dhe mjetet e dëshmimit janë shpallur "indikative" (me përjashtim të K10). Ndryshime të tilla, sipas vetë nenit 24 par. 24.7 të Rregullores Nr. 001/2022 që AK e citon, bëhen përmes njoftimit B54. Së dyti, sqarimi sipas nenit 53 par. 6 u dërgohet vetëm operatorëve që e kanë marrë dosjen, ndërsa Njoftimi për kontratë (B05) – i cili mbetet me emrin e platformës dhe që AK me Vendim e "vërteton" – është i vetmi dokument që e sheh i gjithë tregu. Operatorët që kanë hequr dorë pas leximit të njoftimit nuk e kanë parë kurrë sqarimin. Kjo e cenon transparencën dhe pjesëmarrjen sa më të gjerë.

5. **Kontradikta brenda dosjes.** AK thekson se klauzola e ekuivalencës ishte "e përfshirë tashmë" në dokumentin "Përshkrimi i çmimit". Mirëpo, Aneksi 1 titullohet "Specifikimet teknike të detyrueshme" dhe e përcakton objektin ekskluzivisht si platformën Cabells. Një klauzolë e përgjithshme në një dokument tjetër të dosjes nuk mund të korrigjojë një specifikim të detyrueshëm që emërton një produkt; përkundrazi, ajo dëshmon se dosja është kontradiktore dhe jo transparente.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Klauzola e ekuivalencës gjendet në fund të përshkrimit të produktit, në të njëjtin dokument ("Përshkrimi i Çmimeve") dhe në të njëjtën kolonë me specifikimin; ajo e plotëson specifikimin dhe nuk e kundërshton (Pika 1.4).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Specifikimi i detyrueshëm është Aneksi 1 "Specifikimet teknike të detyrueshme", i cili e emërton platformën Cabells pa "ose ekuivalent". Klauzola në fajllin Excel të çmimeve është formulë e përgjithshme që vlen "për çdo referencë në prodhues", e jo shoqërim i drejtpërdrejtë i referencës, siç e kërkon neni 28 par. 7. Vetë fakti që AK më 16.11.2026 ka pasur nevojë të deklarojë se objekti tani "lexohet" me "ose ekuivalent" dëshmon se kjo nuk ishte e qartë nga dosja e publikuar.

6. **Mungesa e analizës së tregut.** Në Pyetjen 2 kemi kërkuar që AK, nëse nevoja nuk mund të përshkruhet funksionalisht, të paraqesë analizën e tregut. AK nuk ka paraqitur asnjë analizë të tregut dhe nuk ka identifikuar asnjë produkt tjetër në treg që i plotëson kumulativisht kriteret K1–K10. Një ekuivalencë e pranuar vetëm formalisht, por faktikisht e pamundur për t'u përmbushur, nuk e realizon qëllimin e nenit 1 të LPP-së për përdorim efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *LPP nuk e kushtëzon referencën në produkt "ose ekuivalent" me paraqitjen e një analize të tregut; detyrimi i AK-së është që specifikimi të jetë i qartë dhe i lidhur me lëndën (Pikat 1.2, 1.5, 7.5).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Neni 28 par. 7 e lejon referencën në markë vetëm "në kushte të jashtëzakonshme" dhe vetëm nëse AK "në mënyrë të qartë vërteton" se specifikimi nuk mund të përpilohet ndryshe. Kjo është barrë e AK-së, e cila nuk mund të përmbushet pa njohjen e tregut. AK as në sqarim, as në Vendim nuk ka identifikuar asnjë produkt tjetër përveç Cabells që i plotëson kumulativisht K1–K10, dhe në vend të kësaj e ka zhvendosur barrën te ankuesi. Për më tepër, në pikën 3 të Vendimit AK e mbështet nevojën në Shtojcën VII të Rregullores 1/282, e cila përmend shprehimisht "Cabells' Predatory Reports … (pas sigurimit të qasjes nga UP)" – çka dëshmon se produkti ishte paracaktuar – ndërsa në përgjigjen e Pyetjes 7 AK ka pranuar se kjo Shtojcë "nuk është bazë ligjore për blerjen e produktit të një prodhuesi të caktuar".

Neni 7 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Neni 7 i LPP-së e ndalon AK-në që përmes specifikimit të lëndës, kërkesave apo specifikacioneve teknike të favorizojë ose të diskriminojë një ose më shumë operatorë ekonomikë (par. 3) dhe e obligon të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme dhe eliminimin e specifikimeve diskriminuese (par. 6, pikat i dhe iii). Specifikimet e Pjesës 1, edhe pas sqarimit të datës 16.11.2026, e shkelin këtë dispozitë për arsyet në vijim:

1. **Referenca në markë (Aneksi 1 – Objekti; Pyetja 1 dhe 7).** Objekti emërton në mënyrë eksplicite platformën "Cabells (Predatory Reports)". Në përgjigjen e Pyetjes 7 AK ka konfirmuar se Shtojca VII e Rregullores së UP-së "nuk është bazë ligjore për blerjen e produktit të një prodhuesi të caktuar" dhe se LPP ka përparësi ndaj akteve të brendshme. Me këtë, AK ka pranuar se nuk ekziston asnjë bazë normative që e detyron atë të blejë pikërisht

platformën Cabells. Për rrjedhojë, mbajtja e emrit të kësaj platforme në emërtimin e aktivitetit dhe në objekt nuk ka arsye objektive dhe e favorizon drejtpërdrejt prodhuesin e saj dhe partnerët e tij.

Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Referenca shërben vetëm për të përcaktuar llojin dhe nivelin e cilësisë; shërbimi nuk është i standardizuar sipas nenit 28 par. 4 dhe 5; klauzola e ekuivalencës ka qenë pjesë e dosjes që nga publikimi (Pikat 7.1, 28.1, 28.2).*

Kundërargumenti i ankuesit: Në faqen 4 të Vendimit AK deklaron se "Kriteret K1–K9 janë marrë fjalë për fjalë nga specifikimi i publikuar" dhe se K10 është "përcaktuar në specifikimin e publikuar që nga fillimi". Nëse është kështu, atëherë shërbimi ishte i përshkruar tashmë në terma funksionalë dhe emri i markës nuk kishte asnjë funksion tjetër përveç favorizimit të një produkti. Mbajtja e emrit të platformës në objekt dhe në emërtim nuk ka arsye objektive dhe është në kundërshtim me nenin 7 par. 3.

2. **Kërkesa për prodhues ose partner të autorizuar (Aneksi 1 – Ofruesi; Pyetja 3).** AK sqaron se ofertuesi duhet të jetë "prodhues i zgjidhjes ekuivalente që ofron ose partner i autorizuar nga prodhuesi i saj". Duke pasur parasysh se kriteret kumulative K1–K10 (në veçanti K3 dhe K10) të përshtatura me një produkt të vetëm faktikisht mund të përmbushen vetëm nga platforma e referuar, kjo kërkesë i jep një pale private – prodhuesit – kontrollin mbi atë se cili operator ekonomik mund të konkurrojë. Kjo bie në kundërshtim me nenin 7 par. 5 pika (ii), që e ndalon AK-në të kërkojë nga OE furnizimin e produkteve që rrjedhin nga një person ose ndërmarrje e veçantë. Qëllimet që AK i deklaron (licencë e ligjshme për 36 muaj, në emër të UP-së, pa rrezik ndërprerjeje) mund të arrihen me masa më pak kufizuese, p.sh. me deklaratë/dëshmi për të drejtën e ligjshme të licencimit dhe me garanci kontraktuale për vazhdimësinë e shërbimit, pa e kushtëzuar pjesëmarrjen me autorizimin e prodhuesit.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Licencë të ligjshme mund të lëshojë vetëm bartësi i të drejtave ose subjekti i autorizuar prej tij; kërkesa i referohet produktit të ofertuar dhe nuk i jep kontroll asnjë pale private (Pika 7.2).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Për sa kohë që kombinimi i K1–K10 (sidomos K3 dhe K10) faktikisht përmbushet vetëm nga platforma e referuar, "produkti i ofertuar" është në praktikë vetëm ai, dhe pjesëmarrja varet nga vullneti i prodhuesit të tij për të autorizuar partnerë. AK nuk ka shpjeguar pse qëllimet e saj nuk mund të arrihen me masa më pak kufizuese (dëshmi për të drejtën e ligjshme të licencimit dhe garanci kontraktuale për vazhdimësinë e shërbimit).

3. **Pragu "mbi 20.000 revista të vlerësuara" (K3; Pyetja 4).** Në Pyetjen 4 kemi theksuar se ky prag përkon me bazën e të dhënave të një ofruesi të vetëm. AK në përgjigje nuk e ka mohuar këtë fakt, dhe as nuk ka shpjeguar pse pragu është vendosur pikërisht në 20.000 revista dhe jo në një nivel tjetër. Arsyetimi i AK-së ("sa më e vogël mbulueshmëria, aq më i madh rreziku") është i përgjithshëm dhe nuk mbështetet në asnjë analizë të nevojës – p.sh. në numrin e revistave ku publikojnë realisht studentët dhe stafi i UP-së. Për më tepër, numri i revistave të listuara nuk është tregues i cilësisë së vlerësimit: saktësia e verifikimit varet nga metodologjia, kriteret e publikuara dhe përditësimi, e jo vetëm nga sasia. Një prag numerik i kalibruar sipas madhësisë së një baze të caktuar të dhënash funksionon si specifikim i mbyllur.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Pragu është kërkesë minimale për mbulueshmëri, i arsyetuar me faktin se UP-ja ka fakultete në të gjitha fushat; sa më e vogël mbulueshmëria, aq më i madh rreziku i rezultatit negativ të rremë (Pikat 7.3, 28.5).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Ky arsyetim mund të justifikonte çdo prag (10.000, 15.000 ose 25.000) dhe nuk shpjegon pse është zgjedhur pikërisht 20.000. AK nuk ka

paraqitur asnjë analizë të nevojës (p.sh. numrin e revistave ku publikojnë realisht studentët dhe stafi i UP-së) dhe – as në sqarim, as në Vendim – nuk e ka mohuar faktin se pragu përkon me madhësinë e bazës së të dhënave të një ofruesi të vetëm.

4. **Kërkesa për përdorim institucional (K10; Pyetja 6).** Kërkesa që platforma të jetë në përdorim në së paku 5 universitete nga 400 më të mirat sipas THE/QS ose në 5 universitete publike të BE-së, e dëshmuar me konfirmim nga institucionet, nuk përshkruan asnjë karakteristikë funksionale ose ekzekutuese të produktit; ajo mat përhapjen tregtare të një marke. AK e ka riklasifikuar këtë kërkesë si "specifikim teknik" dhe jo si kriter të kapacitetit teknik sipas nenit 69 të LPP-së, por ky riklasifikim nuk e ndryshon natyrën e saj: përmes tij anashkalohen kërkesat për lidhshmëri me objektin dhe proporcionalitet, që zbatohen për kriteret e përzgjedhjes. Kërkesa i përjashton automatikisht zgjidhjet e reja ose rajonale që mund t'i plotësojnë plotësisht kriteret funksionale K1–K9, dhe e bën dëshminë të varur nga vullneti i palëve të treta (universiteteve) për të lëshuar konfirmime. Për më tepër, AK ka përcaktuar që pikërisht për K10 nuk vlen liria e mjeteve të dëshmimit, gjë që e rrit më tej efektin kufizues.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *K10 zbaton të njëjtin standard (400 universitetet më të mira sipas THE/QS) që UP-ja e përdor në Rregulloren 1/282; kërkesa është alternative, proporcionale dhe dëshmohet lehtë (Pikat 7.4, 28.3, 28.6).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Në të gjitha dispozitat e cituara nga AK (neni 17 par. 12.7, Shtojca VII, Shtojca V), ky standard përdoret për vlerësimin e personave dhe institucioneve akademike – anëtarë komisionesh, shtëpi botuese, diploma të kandidatëve – e jo të karakteristikave teknike të një produkti softuerik. Bartja e tij në specifikim teknik nuk ka lidhje me lëndën e kontratës. K10 mat përhapjen tregtare të një marke, pra në thelb është kriter reference, i cili përmes riklasifikimit si "specifikim teknik" i shmanget testit të lidhshmërisë dhe proporcionalitetit që vlen për kriteret e kapacitetit sipas nenit 69.

5. **Efekti kumulativ.** Edhe nëse secila prej kërkesave të mësipërme, e shikuar veçmas, mund të paraqitet si neutrale, kombinimi i tyre kumulativ – emri i markës, autorizimi nga prodhuesi, pragu numerik i përshtatur, metodologjia e njëjtë me atë të Cabells dhe kërkesa për referenca institucionale të një niveli të caktuar – krijon një profil që, sipas njohurive të OE-së për tregun përkatës, përputhet vetëm me një produkt. Kjo e redukton ose e eliminon konkurrencën, në kundërshtim me nenin 7 par. 2 dhe 3 të LPP-së.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Kërkesat rrjedhin nga nevoja funksionale e UP-së dhe zbatohen njëlloj për çdo zgjidhje; pretendimi për "efekt kumulativ" është i përgjithshëm dhe i padëshmuar, sepse UNISOFT nuk identifikon asnjë produkt të përjashtuar (Pikat 1.2, 1.5, 7.5).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Neni 7 par. 6 pika (iii) e obligon AK-në që t'i eliminojë specifikimet diskriminuese, ndërsa neni 28 par. 7 i kërkon asaj që ta vërtetojë nevojën për referencë në markë. Zbatimi "i njëjtë për të gjithë" i një specifikimi që vetëm një produkt mund ta plotësojë nuk e bën atë jo-diskriminues. AK është ajo që duhet të dëshmojë se K1–K10 mund të plotësohen nga më shumë se një produkt – gjë që nuk e ka bërë.

6. **Kritere jashtë dosjes së publikuar (neni 7 par. 6, pikat iv dhe v).** Kriteret K1–K10, metodat e dëshmimit dhe riformulimi i kërkesave nuk janë saktësuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, por vetëm në dokumentin sqarues të datës 16.11.2026, ndërsa AK refuzon ndryshimin formal të dosjes. Kjo e cenon parimin e transparencës dhe kërkesën që të gjitha specifikimet dhe kriteret e përdorura në vlerësim të jenë të saktësuara në njoftim dhe në dosjen e tenderit.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Kriteret K1–K10 nuk janë jashtë dosjes: ato janë pjesë e sqarimit zyrtar të publikuar në e-Prokurimi, dhe K1–K9 janë marrë fjalë*

për fjalë nga specifikimi i publikuar (Pikat 1.3, 7.6, 28.4).

Kundërargumenti i ankuesit: Qëndrimi i AK-së e vë atë para një dileme: ose (i) kriteret funksionale K1–K10 ishin në specifikim – dhe atëherë referenca në markë ishte e panevojshme dhe e paligjshme sipas nenit 28 par. 3 dhe 7; ose (ii) ato janë formuluar rishtazi në sqarim – dhe atëherë janë kritere të futura jashtë Njoftimit për kontratë dhe Aneksit 1, në kundërshtim me nenin 7 par. 6 pikat (iv) dhe (v). Në secilin rast, shkelja ekziston.

Neni 28- Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

1. Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.

2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera.

4. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

5. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës.

6. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me

fjalët "ose ekuivalent"

8. Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Standardet apo specifikimet e tjera të paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni mund të përdoren si një mjet i ruajtjes së përputhshmërisë me kërkesat ekzekutuese apo funksionale.

9. Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për refuzimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është në përputhshmëri me një specifikim të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni nëse specifikimi i tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutuese ose funksionale dhe është i përshtatshëm. Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrën më të përshtatshme (siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimit nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me specifikimet e lartpërmendura gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale të autoritetit kontraktues.

10. Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

1. **Shkelja e paragrafit 7 – referenca në markë pa "ose ekuivalent".** Aneksi 1 "Specifikimet teknike të detyrueshme" i publikuar me Njoftimin për Kontratë më 03.11.2026 e përcakton objektin si "licencë për qasje institucionale në platformën Cabells (Predatory Reports)", pa fjalët "ose ekuivalent". Fakti që AK në përgjigjen e Pyetjes 1 deklaron se referenca tani "lexohet" me fjalët "ose ekuivalent" përbën pranim se dosja e publikuar nuk i përmbante ato. Pra, specifikimi i detyrueshëm teknik ishte hartuar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 28 par. 7 të LPP-së.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Parimi i ekuivalencës ka qenë pjesë e dosjes që nga publikimi (klauzola në "Përshkrimi i Çmimeve"); me sqarimin e 16.11.2026 kërkesa e nenit 28 par. 7 "është plotësuar" (Pikat 7.1, 28.1, 28.2).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Neni 28 par. 7 kërkon që vetë referenca në markë të "shoqërohet" me fjalët "ose ekuivalent". Aneksi 1 – dokumenti që përmban "specifikimet teknike të detyrueshme" – nuk i përmban ato. Fakti që AK pranon se kërkesa "është plotësuar" vetëm me sqarimin e 16.11.2026 konfirmon se dosja e publikuar më 03.11.2026 nuk e plotësonte atë.

2. **Kushti i "pamundësisë" sipas paragrafit 7 nuk është plotësuar – AK vetë e ka përshkruar shërbimin funksionalisht.** Referenca në produkt lejohet vetëm "në kushte të jashtëzakonshme" dhe vetëm nëse AK "në mënyrë të qartë vërteton" se nuk është e mundur të përpilohet specifikim mjaft i saktë dhe i kuptueshëm. Në përgjigjen e Pyetjes 1 AK pretendon se shërbimi nuk mund të përshkruhet vetëm përmes kërkesave funksionale. Mirëpo, në përgjigjen e Pyetjes 2 – në të njëjtin dokument – AK e ka përshkruar shërbimin në tërësi në terma funksionalë dhe të matshëm, përmes kritereve K1–K10. Me këtë, AK ka vërtetuar të kundërtën e asaj që pretendon: objekti mund të përshkruhet funksionalisht pa iu referuar një marke. Rrjedhimisht, referenca në platformën Cabells nuk ka bazë në nenin 28 par. 7 dhe duhet të hiqet nga objekti, nga emërtimi i aktivitetit dhe nga Njoftimi për Kontratë. Po ashtu, mungesa e një standardi sipas par. 4 dhe 5 nuk e lejon automatikisht referencën në markë; në këtë rast par. 3 e obligon AK-në të formulojë kërkesa ekzekutuese ose funksionale.

Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Shërbimi i kërkuar nuk është i standardizuar me ndonjë standard sipas nenit 28 par. 4 dhe 5; kriteret K1–K10 nuk e përjashtojnë këtë arsyetim, por e plotësojnë referencën (Pikat 7.1, 28.1, 28.2).*

Kundërargumenti i ankuesit: Mungesa e standardit nuk e hap rrugën për referencë në markë; në këtë rast neni 28 par. 3 e obligon AK-në të formulojë kërkesa ekzekutuese ose funksionale. AK e ka bërë pikërisht këtë me K1–K10 dhe, sipas Vendimit, kriteret K1–K9 ishin "fjalë për fjalë" në specifikimin e publikuar. Rrjedhimisht, AK nuk ka vërtetuar – siç kërkon par. 7 – se ishte e pamundur të përpilohej specifikim i saktë pa e emërtuar platformën.

3. **Shkelja e paragrafit 2 – specifikime jo në përputhje me qëllimin dhe që favorizojnë.** Qëllimi i deklaruar i prokurimit (Aneksi 1 dhe pika 1 e përgjigjes së AK) është verifikimi i revistave me praktika editoriale joetike. Ky qëllim mund të arrihet nga çdo bazë të dhënash e kuruar, me kritere të publikuara, klasifikim të shkeljeve dhe përditësim të rregullt. Pragu "mbi 20.000 revista" (K3) dhe përdorimi në universitete të renditura (K10) nuk rrjedhin nga qëllimi i prokurimit, por nga karakteristikat e një produkti të caktuar; ato nuk sigurojnë "qasjen sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik", por e ngushtojnë atë.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *K3 është kërkesë minimale e mbulueshmërisë, e lidhur me detyrimet e verifikimit sipas akteve të UP-së; K10 zbaton standardin THE/QS të Rregullores 1/282 (Pikat 7.3, 7.4, 28.5).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Aktet e UP-së përcaktojnë detyrimin për të verifikuar revistat, por nuk përcaktojnë as pragun 20.000, as kërkesën që softueri të përdoret në universitete të renditura. Këto dy kërkesa nuk rrjedhin nga qëllimi i prokurimit, por nga karakteristikat e një produkti të caktuar (shih pikat 3 dhe 4 te neni 7), dhe nuk sigurojnë "qasjen sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik".

4. **Shkelja e paragrafit 1 – specifikimet e detyrueshme jashtë dosjes së tenderit.** Kriteret minimale dhe të detyrueshme K1–K10, metodat e dëshmimit dhe riformulimi i kërkesës për klasifikim nuk janë pjesë e Aneksit 1 të publikuar, por vetëm e dokumentit sqarues. Neni 28 par. 1 kërkon që të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike të parashtrohen në dosjen e tenderit. Deklarata e AK se "ndryshimi i dosjes nuk është i nevojshëm" e lë dosjen e publikuar në kundërshtim me kushtet që AK synon t'i zbatojë në vlerësim.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Sqarimi u publikua në e-Prokurimi dhe është pjesë e dosjes; nuk ka pasiguri se cili tekst zbatohet (Pikat 1.3, 7.6, 28.4).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Neni 28 par. 1 kërkon që të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike të parashtrohen në dosjen e tenderit dhe, kur publikohet njoftim, edhe në njoftim. Njoftimi B05 dhe Aneksi 1 mbeten të pandryshuara dhe në kundërshtim me sqarimin. Ekzistenca e dy teksteve kontradiktore – njëri që emërton Cabells pa ekuivalencë dhe tjetri që e "lexon" ndryshe – është vetë pasiguria juridike që neni 28 par. 1 synon ta parandalojë.

5. **Shkelja e paragrafit 8 – kërkesa funksionale të pasakta.** Disa nga kriteret e ekuivalencës janë formuluar në mënyrë të paqartë dhe nuk mundësojnë vlerësim objektiv: "mbi 20.000 revista të vlerësuara" (K3) – nuk përcaktohet nëse llogariten vetëm revistat me shkelje të dokumentuara apo të gjitha revistat e shqyrtuara; "sistem ekuivalent i shkallëzuar" (K5) dhe "zgjerohet rregullisht" (K6) – nuk përcaktohen parametra matës. Për më tepër, AK i cilëson mjetet e dëshmimit si "indikative". Kjo i lë komisionit vlerësues diskrecion të pakufizuar dhe nuk u mundëson ofertuesve të përcaktojnë me saktësi se çfarë duhet të ofrojnë, në kundërshtim me nenin 28 par. 8.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *K5 verifikohet nga dokumenti i metodologjisë, ndërsa K6 nga politika e përditësimit; shpallja e mjeteve të dëshmimit si indikative nuk e zgjeron diskrecionin e komisionit (Pika 28.5).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Neni 28 par. 8 nuk kërkon vetëm që kriteri të jetë i

verifikueshëm, por që kërkesat funksionale "të jenë të sakta". Shprehjet "sistem ekuivalent i shkallëzuar" dhe "zgjerohet rregullisht" nuk kanë asnjë parametër matës (numër minimal nivelesh, frekuencë përditësimi, numër revistash të shtuara), ndërsa te K3 mbetet e paqartë nëse llogariten vetëm revistat me shkelje të dokumentuara apo të gjitha revistat e shqyrtuara. AK nuk iu përgjigj këtij pretendimi.

6. **Shkelja e paragrafëve 6 dhe 9 – kufizimi i mjeteve të dëshmimit.** Neni 28 par. 6 dhe 9 i lejon tenderuesit ta dëshmojnë ekuivalencën "përmes çfarëdo mase të duhur". AK, ndërkaq, e përjashton kriterin K10 nga ky rregull dhe e kushtëzon dëshminë me konfirmime nga institucione të treta ose linqe në ueb-faqet e tyre zyrtare. Kjo e kufizon në mënyrë të pajustifikuar të drejtën e tenderuesit për të dëshmuar ekuivalencën.

   Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Mjetet e dëshmimit për K10 janë përcaktuar në specifikim që nga fillimi dhe janë të njohura për të gjithë; për K1–K9 mjetet janë indikative (Pikat 7.4, 28.6).*

   Kundërargumenti i ankuesit: Fakti që kufizimi është i njohur për të gjithë nuk e bën atë të ligjshëm. Neni 28 par. 6 dhe 9 i lejon tenderuesit ta dëshmojë ekuivalencën "përmes çfarëdo mase të duhur", pa përjashtime. Kushtëzimi i K10 me konfirmime nga institucione të treta e bën pjesëmarrjen të varur nga vullneti i palëve të treta dhe përjashton zgjidhjet e reja ose rajonale që mund t'i plotësojnë plotësisht kriteret funksionale K1–K9.

7. **Përfundim.** Bazuar në sa më sipër, Pjesa 1 e këtij aktiviteti të prokurimit është hartuar në kundërshtim me nenet 1, 7 dhe 28 të LPP-së. Sqarimi i datës 16.11.2026 nuk i ka eliminuar shkeljet, por i ka zhvendosur ato jashtë dosjes formale të tenderit dhe jashtë Njoftimit për kontratë, ndërsa Vendimi i AK-së i datës 23.11.2026 – i përgatitur nga vetë hartuesi i specifikimeve të kontestuara – nuk ka dhënë arsyetim bindës për asnjërin prej pretendimeve dhe e ka zhvendosur barrën e provës te operatori ekonomik.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. Të aprovojë ankesën e UNISOFT L.L.C. si të bazuar;
2. Të anulojë Vendimin e AK-së – Universiteti i Prishtinës, të datës 23.11.2026;
3. Ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, me obligim që AK: (a) të anulojë aktivitetin për Pjesën 1; ose (b) të ndryshojë formalisht dosjen e tenderit dhe Njoftimin për kontratë (B54) duke: hequr emrin e platformës Cabells nga emërtimi i aktivitetit dhe nga objekti; formuluar specifikime teknike neutrale, funksionale dhe të matshme në Aneksin 1; rishikuar ose hequr pragun numerik K3 në bazë të një analize të arsyetuar të nevojës; hequr ose zbutur kërkesën K10; zëvendësuar kërkesën për autorizim nga prodhuesi me dëshmi për të drejtën e ligjshme të licencimit; dhe publikuar ndryshimet në platformën e-Prokurimi me zgjatje përkatëse të afatit për dorëzimin e ofertave, sipas nenit 53 të LPP-së;
4. Të pezullojë aktivitetin e prokurimit për Pjesën 1 deri në vendimin përfundimtar për këtë ankesë;
5. Të angazhojë ekspert shqyrtues të pavarur për vlerësimin e specifikimeve teknike të Pjesës 1;
6. T'ia kthejë ankuesit tarifën e ankimit, në pajtim me nenin 118 të LPP-së.

Kërkojmë nga OSHP që të nxjerrë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE UNISOFT L.L.C.,

ANULOHET Vendimi i AK-së – Universiteti i Prishtinës i datës 23.11.2026 dhe aktiviteti i prokurimit nr. 242-26-9681-1-2-1, të ndryshohet në përputhje me LPP

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si OE UNISOFT L.L.C. kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit. Dëmi reflektohet në dëmin material dhe jomaterial, i cili shtrihet edhe në raport me LMD nenet 136 dhe 137, duke mos u kufizuar në dëmtimin e imazhit dhe pasoja të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

Qëndrimi i AK në Vendimin e 23.11.2026: *Aktiviteti është në fazën para dorëzimit të ofertave dhe UNISOFT mund të ofertojë si çdo operator tjetër; prandaj nuk mund të jetë shkaktuar dëm (Pika 8).*

Kundërargumenti i ankuesit: Ky formular dhe LPP mbrojnë edhe nga dëmi që "kërcënohet" të shkaktohet. Mundësia formale për të ofertuar nuk ka vlerë kur specifikimet përputhen me një produkt të vetëm; ankuesi vendoset në pozitë të pabarabartë që nga fillimi dhe rrezikon humbjen e mundësisë për të konkurruar për një kontratë 36-mujore. Ankuesi rezervon të drejtën për kompensim të dëmit në procedurë të veçantë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Dokumentet e bashkëngjitura kësaj ankese:

1. Njoftimi për kontratë (B05) i publikuar më 03.11.2026 – pika a);
2. Dosja e tenderit – Aneksi 1 "Specifikimet teknike të detyrueshme" (Pjesa 1) dhe dokumenti "Përshkrimi i çmimeve";
3. Kërkesa për informacione shtesë / sqarime e UNISOFT L.L.C. (Aneksi 5), e datës 13.11.2026 – pika g);
4. Përgjigja e AK-së në kërkesën për informacione shtesë / sqarime, e datës 16.11.2026 – pika g);
5. Kërkesa për rishqyrtim e UNISOFT L.L.C., e datës 20.11.2026 – pika g);
6. Vendimi i AK-së për kërkesën për rishqyrtim, i datës 23.11.2026 – pika e);
7. Dëshmia e pagesës së tarifës së ankimit sipas nenit 118 të LPP-së – pika f);
8. Certifikata e regjistrimit të biznesit të UNISOFT L.L.C.
9. Dëshmia e dërgimit të kopjes së ankesës Autoritetit Kontraktues (neni 111.2 i LPP-së).

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*